

TERMAT E REFERENCES

1. SFONDI

Republika e Shqipërisë është një vend më të ardhura të mesme-të larta dhe me një popullsi prej 2.9 milion banorë.

Me 2.9 diagnostikime të reja me HIV për 100,000 banorë (2014), barra e HIV-it për Shqipërinë konsiderohet si e ulët. Në fund të Korrikut të vitit 2016, u regjistruan 963 raste pozitive me HIV në Shqipëri, me 457 pacientë nën terapinë ARV. Raporti meshkuj– femër i rasteve të raportuara ka qenë i qëndrueshëm 2:1, ku shumica e rasteve diagnostikohen midis grup moshës 25-44 vjeçare (60%) e ndjekur me grupmoshën 45-54 (17%)⁴.

Prania e një sistemi mbikëqyrjeje të pamjaftueshme kufizon disponueshmërinë e të dhënave për madhësinë e epidemisë HIV në Shqipëri, ku ka shumë pak informacion të disponueshëm për barrën e HIV-it tek grupet kryesore të popullatës – meshkuj që kryejnë marrëdhënie seksuale me meshkuj (MSM), punonjësit e seksit femra (PSF) dhe përdorues droge me injeksion (PDI) si edhe personat e burgosur dhe romë.

Rezultatet e fundit të studimit të mbikëqyrjes biologjike dhe të sjelljes në grupet PDI, MSM dhe PSF⁵ i kryer më 2011, kanë treguar se rreth 24% e PDI-ve kanë injektuar me agje ose shiringa të përdorura gjatë injeksionit të fundit dhe vetëm 61% e PDI-ve nuk kanë përdorur shiringa të përdorura gjatë muajit të fundit. Për më tepër, 48% e PDI-ve kanë raportuar se kanë përdorur prezervativ gjatë marrëdhënies së fundit seksuale që kanë kryer.

Studimi ka treguar gjithashtu se vetëm gjysma e MSM-ve të intervistuar, të cilët kanë pasur një partner seksi tregtar kanë përdorur prezervativ me atë partner gjatë aktit të fundit dhe vetëm 20.3% e MSM-ve kanë raportuar për një përdorim të rregullt të prezervativit me partner seksi tregtar. Edhe pse 76.6% e PSF-ve kanë raportuar se kanë përdorur prezervativ me klientin e tyre më të fundit, vetëm 30% kanë raportuar se përdorin rregullisht prezervativ me klientët e tyre.

Një epidemi e mundshme e panjohur ndërmjet MSM-ve, përqindje e larë e shkëmbimit të shiringave ndërmjet PDI-ve, si edhe një përqindje e lartë e popullatës që nuk janë në dijeni të infeksionit HIV, mund të tregojë një rrezik në të ardhmen për rritjen e epidemisë HIV në vend. Gjithashtu, mangësitë e të dhënave kufizojnë kryerjen e një analize të kaskadës, dhe po kryhet vetëm një monitorim i kufizuar i personave që jetojnë me HIV (PJH) për shkak të një financimi të kufizuar në dispozicion.

Barra e sëmundjes së tuberkulozit është gjithashtu e ulët në Shqipëri. Përqindja e incidencës së TB-së është përkeqësuar nga viti 2012 në 2013 sipas raportit të vendit (13/100,000 kundrejt 16.8/100,000) dhe është stabilizuar në 14.5/100,000, siç është raportuar për 2015⁶.

Shpërndarja gjeografike e incidencës së TB është më e lartë në rajonet veri-lindore dhe në jug incidenca më e lartë e raportuar është 54/100,000. Vdekshmëria e TB është e ulët, ku përqindja e suksesit të trajtimit të rasteve të reja me TB është vazhdimisht duke u përmirësuar gjatë dhjetë viteve të fundit (nga 87% më 2006 në 92% më 2011 dhe 2012) por që është ulur në 88% më 2013⁷. Kapaciteti i Testimit për Ndjeshmërinë e Barnave (TNB) është shumë i kufizuar (vetëm 8% e rasteve të ritrajuara dhe 21% e rasteve të reja të testuara për RR/RSHI-TB në 2014) dhe tregon përqindje shumë të ulët të RSHI-TB me një mesatare prej një rasti në vit.

Aktualisht, nuk ekziston asnjë kapacitet trajtimi për RSHI-TB-në në Shqipëri dhe pacientët RSHI-TB po trajtohen në vendet fqinje, kryesisht në Kosovë. Në vitin 2014, testimi për HIV-in ju ofrua vetëm 41% të të gjithë pacientëve të diagnostikuar me TB, kjo për shkak të një financimi të kufizuar vendas dhe disponueshmërisë së kufizuar të reagentëvetestues.

1. Qëllimi, Strategjitë dhe Veprimtaritë

Qëllimi: Mbajtja nën kontroll e epidemisë TB dhe HIV në nivelet aktuale të ulëta dhe reduktimi i sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë si pasojë e TB dhe HIV në Shqipëri.

Strategjitë:

- Sigurimin e qëndrueshmërisë programatike dhe financiare të programeve kombëtare të HIV-it dhe TB-së;
- Përshkallëzimin e arritjes së grupeve kryesore të popullatës për një identifikim dhe diagnostikim të hershëm të HIV/SIDA;
- Ndërgjegjësimi i popullatës në lidhje me HIV/SIDA dhe TB;
- Reduktimin e stigmatizimit dhe diskriminimit ndaj HIV-it për grupet me rrezik të lartë dhe të cënueshme, përfshirë këtu nga ofruesit e shërbimeve shëndetësore dhe sociale, nga bashkëmoshatarët dhe punonjësit në terren si dhe nga popullata e gjerë;
- Integrimin e diagnostikimit të hershëm të TB-së dhe trajtimit në KPSH;
- Sigurimin e vazhdimësisë së kujdesit pas identifikimit të hershëm për programet e HIV-it dhe TB-së;
- Ndërtimin e sistemeve të mbikëqyrjes të bazuara në prova për programet e HIV-it dhe TB-së;
- Forcimin e mbulimit të përgjigjes ndaj HIV/SIDA dhe TB-së nëpërmjet një qasjeje të rajonalizuar;

Veprimtaritë e Planifikuara:

HIV

1. Përmirësimi i cilësisë dhe përshkallëzimi i ndërhyrjeve parandaluese tek grupet e popullatës më në rrezik përfshirë këtu përdoruesit e drogës me injeksion, PS-të, MSM-të, personat e burgosur dhe romë;
2. Zhvillimi i lidhjeve efikase ndërmjet shërbimeve të parandalimit, diagnostikimit dhe trajtimit të HIV për identifikimin e hershëm të infeksionit dhe referimit për trajtim dhe përkujdesje të HIV-it;
3. Ndërmarrja e fushatave ndërgjegjësuese për parandalimin e HIV dhe marrjes së masave përkatëse;
4. Forcimi i kapacitetit të sistemit shëndetësor për një përgjigje efikase ndaj HIV-it, duke përfshirë ngritjen dhe përmirësimin e sistemeve të mbikëqyrjes së të dhënave në nivelet e komunitetit dhe të ambienteve mjekësore;
5. Sigurimi i forcimit të sistemit të komunitetit për veprimtaritë në terren dhe parandalimin;
6. Mundësimi i ndryshimeve strukturore dhe funksionale në KTV, kaskadën e trajtimit, lidhjet ndërmjet qeverisë dhe OJQ/OSHC-ve, menaxhimi i prokurimit dhe furnizimit si edhe sistemit të mbikëqyrjes shëndetësore;

TB

1. Përshkallëzimi i diagnostikimit të TB dhe RR/RSHI dhe futja e teknologjisë gene Xpert;

2. Ngritja e kapacitetit RSHI-TB për trajtimin dhe kujdesin e pacientëve me RSHI-TB në Shqipëri;
3. Forcimi i kontrollit të infeksionit TB në ambientet e kujdesit shëndetësor;
4. Ofrimi i kujdesit dhe mbështetjes së duhur për pacientët me TB;
5. Forcimi i bashkëpunimit TB/HIV;
6. Ndërmarrja e fushatave ndërgjegjësuese për parandalimin e HIV dhe marrjes së masave përkatëse;

Ndër-sektoriale

1. Forcimi i funksioneve kryesore të sistemit të shëndetësisë për kontrollin e TB dhe HIV/SIDA;
2. Vendosja e lidhjeve ndërmjet ndërhyrjeve për HIV dhe TB me reformën e gjerë shëndetësore dhe programeve të tjera mbështetëse të sistemit shëndetësor;
3. Rritja e kapaciteteve të Programeve Kombëtare për SIDA-n dhe TB-në dhe ndërgjegjësimi më i lartë;

Grupet e synuara/Përfituesit:

- Persona që Injektojnë Drogë;
- Punonjësit e Seksit, MSM-të dhe partnerët e tyre seksualë;
- Personat e burgosur;
- Gratë shtatzëna;
- PJHA;
- Pacientët me TB dhe RSHI-TB;
- Ofruesit e kujdesit shëndetësor të përfshirë në diagnostikimin dhe trajtimin/ menaxhimin e rastit me TB dhe RSHI-TB, përfshirë këtu ofruesit e kujdesit parësor shëndetësor;
- Personeli i Programeve Kombëtare për TB-në dhe HIV/SIDA-n;
- Të rinjtë në risk dhe gratë;

FONDI GLOBAL NË SHQIPËRI

Fondi Global është një mekanizëm financimi që siguron fonde për vendet që mbështesin programet që parandalojnë, trajtojnë dhe kujdesen për njerëzit me HIV dhe AIDS, Tuberkuloz dhe Malaria.

Që nga viti 2005, Fondi Global ka mbështetur luftën kundër HIV/AIDS dhe TB në Shqipëri. Granti i fundit i miratuar është për dy sëmundjet lartpërmendura, si dhe për forcimin e sistemit shëndetësor.

Granti do të sigurojë një reagim katalitik dhe do të ndërtojë struktura që do të mbështesin lidhjen midis qeverisë dhe institucioneve kombëtare, duke u fokusuar në qëndrueshmërinë financiare të programeve kombëtare të tuberkulozit dhe HIV si dhe ndërmarrjes së një fushate ndërgjegjësimi dhe për popullsinë në rrezik. Programi i jep prioritet ndërhyrjeve që adresojnë problematikat e tuberkulozit dhe HIV-it në vend, identifikimit dhe zgjerimit të ndërhyrjeve tek popullatat kyçe të

prekura në qytetet e zgjedhura; ndërgjegjësimi; uljen e stigmës dhe diskriminimit; akses të barabartë dhe ofrimin e shërbimeve me cilësi të lartë për parandalimin, trajtimin, kujdesin dhe mbështetjen me fokus në popullatat kyce më të prekura dhe TB.

Zbatimi i aktiviteteve

Si Përfituesi Kryesor (PR) i Grantit të Fondit Global për HIV dhe TB në Shqipëri, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale kërkon të angazhojë partnerë kombëtarë, të quajtur nën-kontraktor (SR), për të zbatuar një pjesë të aktiviteteve të granteve. Angazhimi i partnerëve si SR është thelbësor për zbatimin e suksesshëm të granteve, forcimin e kapaciteteve kombëtare, promovimin e qasjes në vend dhe qëndrueshmërinë afatgjatë të programeve. Organizatat kombëtare shpesh kanë njohuri më të detajuara rreth situatës dhe kushteve lokale dhe aftësi që mund të rrisin ndjeshëm ndikimin e programit të Fondit Global.

MHSP do të angazhojë SR për të qënë një partner përgjegjës në zbatimin e një programi të financuar nga Fondi Global për aktivitetet e përzgjedhura të programit. Pasi të angazhohen nga MHSP, SR-të janë përgjegjëse për zbatimin e aktiviteteve të programit, menaxhimin transparent të fondeve dhe arritjen e rezultateve të dakorduara brenda buxhetit të dakorduar dhe planit të punës. Me kërkesën aktuale për propozime, MHSP kërkon SR për të mbështetur zbatimin e aktiviteteve të granteve të paraqitura në grantin e ri.

2. FUSHAT E SHËRBIMEVE DHE PËRGJEGJËSITË

MHSP kërkon partnerë të punojnë si nën-kontraktorë për modulet e granteve të HIV dhe TB. Një partner mund të aplikojë për një ose më shumë module. Gjithashtu, partnerët e ndryshëm mund të krijojnë një sipërmarrje të përbashkët (të konfirmuar me noteri) për të aplikuar së bashku për një ose më shumë module.

1. PROGRAMET E PARANDALIMIT PËR MSM DHE TG

OBJEKTIVAT

Qëllimi i kontratës është të kontrollojë dhe të parandalojë përhapjen e mëtejshme të HIV në popullatën MSM dhe TG në rrethet e përzgjedhura të vendit. Kontraktuesi do të ofrojë një paketë shërbimesh të përshkruara si më poshtë.

Ndërhyrjet do të zhvillohen në Tiranë dhe në rrethet e tjera si Durrës, Vlorë, Elbasan, Korçë, dhe Shkodër. Tirana ka komunitetin më të madh të MSM dhe synohet të arrihen 70% e numrit të planifikuar të MSM, ndërsa në rrethet 30%.

Fushat e Shërbimeve për MSM dhe TG. Organizata zbatuese do të ofrojë paketën e mëposhtme të shërbimeve për MSM dhe TG. Organizata do të përgatisë planin vjetor të punës për zbatimin e këtyre shërbimeve:

- Edukimi për shëndetin seksual dhe riprodhues dhe sëmundjeve seksualisht të transmetueshme;
- Informacion, edukim dhe komunikimi synuar për MSM dhe TG;
- Programet e shpërndarjes dhe promovimit të përdorimit të kondomit për MSM dhe TG dhe partnerët e tyre seksual;
- Ofrimin e shërbimeve të këshillimit dhe testimit për HIV;
- Promovimi i një mjedisi të përshtatshëm për të mbështetur zbatimin e projektit dhe për të zvogëluar stigmën kundër MSM dhe TG;
- Sensibilizimi i popullsisë në risk në lidhje me HIV dhe TG për masa parandaluese, si dhe për popullsinë e prekur.

Më poshtë përshkruhet secili prej këtyre shërbimeve në detaje.

1. Zbatimi i strategjive të përshtatshme të ndryshimit të sjelljes

- Ngritja e Pikave të Palëvizshme Të Shërbimit (PSHP) - si struktura kyçe për ofrimin e shërbimeve gjithëpërfshirëse për MSM dhe TG;
- Ofrimi i shërbimeve për MSM dhe TG nëpërmjet ngritjes së njësive të lëvizshme (furgonë), të cilat do të lejojnë arritjen e MSM në vendet ku ata takohen dhe mbledhen, si në parqe, bare, etj. Ekipi do të veprojë në bashkëpunim të ngushtë me (PSHP) dhe do ofrojë një sërë shërbimesh përfshirë testimin;
- Punësimi dhe përgatitja e punonjësve në terren (outreach);
- Trajnimi nëpërmjet edukatorëve bashkëmohatarë në përdorimin e duhur të kondomit, njohuritë për HIV dhe IST;
- Zhvillimi i materialeve të Informim Edukim Kounikimit për MSM dhe TG, me fokus në nevojat e MSM, që përfshin: përgatitjen, fokus grupet për të testuar materialet e reja, shtypjen dhe shpërndarjen. Materialet e IEC do të shpërndahen në terren, njësitë e lëvizshme, dhe pikat e palëvizshme nga punëtorët socialë / outreach. Numri i MSM të planifikuar për të marrë materiale të tilla do të jetë në përputhje objektivin e mbulimit çdo vit.
- Ndërmarrja e fushatave ndërgjegjësuese dhe hartimi i një plani komunikimi në lidhje me HIV dhe TG.

2. Sigurimi i shpërndarjes të kondomit

- Sigurimi që kondomët janë lehtësisht të disponueshëm në zonën e projektit;
- Promovimi i përdorimit të kondomit nëpërmjet shpërndarjes falas të prezervativëve përmes PSHP, edukatorëve bashkëmohatarëve/punonjësve në terren, shërbimeve lokale të IST;
- Rishikimi i aktiviteteve të edukimit dhe shpërndarjes së kondomit në bazë të përvojës së projektit dhe rezultateve nga mbikëqyrje e sjelljes.

3. Ofrimin e shërbimeve të këshillimit dhe testimit për HIV (TKH)

- Sigurimi i trajnimit për TKH të stafit të projektit për të siguruar shërbime të aksesueshme dhe pranueshme për MSM dhe TG;
- Ofrimi i këshillimit për HIV dhe testimi i shpejtë në PSHP për MSM dhe të TG;
- Ofrimi i testimit në vendet ku MSM dhe TG mbledhen, i cili do të promovohet dhe kryhet përmes njësive mobile;
- Krijimi i shërbimeve TKH në mënyrë që MSM dhe TG të kenë akses në shërbime ose t'i referohen/t'i shoqërojnë ata në qendrat ekzistuese të TKH;
- Monitorimi i përvojës së MSM dhe TG në shërbimet e TKH dhe ndërmarrja e veprimeve korrigjuese në përmirësimin e aktiviteteve edukative dhe testimit.

4. Promovimi i një mjedisi të përshtatshëm për të adresuar stigmën

- Identifikimi i organizatave/personave ose faktorëve të tjerë që mund të pengojnë progresin e implementimit. Zhvillimi i një plani për të promovuar një mjedis sa më pozitiv për shërbimet e reduktimit të dëmeve për MSM dhe TG.
- Ndërmarrja e aktiviteteve advokuese dhe edukuese për të promovuar dhe siguruar mirëkuptimin e zyrtarëve të qeverisjes vendore, punonjësve të zbatimit të ligjit dhe aktorëve të tjerë lokal për rëndësinë së aktiviteteve gjithëpërfshirëse për parandalimin e HIV.
- Monitorimi i dhunës kundër MSM dhe TG dhe ndërmarrja e veprimeve të duhura.

2. PROGRAMET E PARANDALIMIT PËR PERSONAT QË INJEKTOJNË DROGA (PID) DHE PARTNERËT E TYRE

OBJEKTIVAT

Qëllimi i kontratës është të kontrollojë dhe të parandalojë përhapjen e mëtejshme të HIV në popullatën e PID në qytetet e përzgjedhura të vendit. Kontraktuesi do të dorëzojë një paketë shërbimesh të përshkruara si më poshtë.

Ndërhyrjet do të zhvillohen në Tiranë dhe rrethet e tjera, Durrës, Vlorë, Elbasan, Korçë dhe Berat.

Ndërsa Tirana ka popullatën më të madhe të PID është planifikuar të arrihet 65%, ndërsa në rrethet 35%.

Fushat e shërbimeve për PID. Organizata zbatuese do të ofrojë paketën e plotë të shërbimeve të mëposhtme për **PID**. Organizata do të përgatisë planin vjetor të punës për zbatimin e këtyre shërbimeve:

- Programet e shkëmbimit të shiringave;
- Referimi në terapinë zëvendësuese me opioidë (OST) dhe trajtimin e varësisë nga droga duke përfshirë detoksifikimin;
- Edukimi për shëndetin seksual dhe riprodhues dhe IST;

- Informacion edukim dhe komunikim i synuar për personat që injektojnë drogë dhe partnerët e tyre seksualë;
- Shpërndarja e kondomve dhe programet e edukimit për PID dhe partnerët e tyre seksual;
- Ofrimin e shërbimeve të këshillimit dhe testimit për HIV(TKH)
- Sigurimi i trajtimit të plagëve;
- Promovimi i një mjedisi të përshtatshëm për të mbështetur zbatimin e projektit dhe për të zvogëluar stigmën kundër PID.

Më poshtë përshkruhet secili prej këtyre shërbimeve në detaje.

1. Sigurimi i shërbimeve për reduktimin e dëmit

- Ngritja e Pikave të Shërbimit të Palëvizshme (PSHP), - si struktura kryesore për ofrimin e shërbimeve gjithë përfshirëse për PID në mënyrë të integruar siç janë: shërbimet në terren; shërbimet specifike të fermrave që injektojnë droga; mbështetje psiko-sociale për PID dhe familjet e tyre; informim, edukim dhe komunikim (IEK) për HIV, përdorimin e drogës dhe infeksione të tjera të transmetuara nëpërmjet gjakut; akses në shërbimet e testimit për HIV; sigurimi i trajtimit të plagëve; referimi ndaj trajtimit për varësinë nga droga; ngritja e kapaciteteve ndërmjet ofruesve të shërbimeve; mbrojtjes dhe rrjetëzimit për zvogëlimin e dëmeve dhe qasjen në shërbime.
- Ofrimi i shërbimeve të reduktimit të dëmit përmes njësive të lëvizshme (furgona), të cilat do të lejojnë arritjen e PID në vende ku takohen dhe injektojnë.
- Sigurimi i pajisjeve sterile për injektim.

2. Zbatimi i strategjive të përshtatshme për ndryshimin e sjelljes

- Zhvillimi i një programi për të plotësuar nevojat shëndetësore të PID, në bazë të vlerësimit të situatës, gjetjeve të mbikëqyrjes dhe përfshirjes së përdoruesve të tanishëm dhe atyre të mëparshëm. Programi duhet të inkorporojë metodologjitë efektive të edukimit të bashkëmoshatarëve, strategjitë ndërpersonale të komunikimit, rekrutimin e stafit në terren dhe ndërtimin e aftësive.
- Punësimi dhe trajnimi i punonjësve dhe edukatorëve bashkëmoshatarë nga nëngrupe të ndryshme të PID përfshirë PID femra. Të sigurohet trajnimi i vazhdueshëm dhe mbikëqyrja efektive e edukatorëve bashkëmoshatarë.
- Trainimi përmes edukatorëve bashkëmoshatarë për të ndërtuar aftësitë e PID në praktikën e sigurta të injektimit, përdorimin e duhur të kondomit, njohuritë për IST dhe edukimin e tyre për reduktimin e abuzimit me drogën
- Zhvillimi i materialeve të Informim Edukim Komunikimit IEK për PID, me informacion mbi rrezikun e transmetimit të HIV/TB/IST. Materialet IEK do të shpërndahen përmes kontakteve, njësive të lëvizshme, nga punonjësit socialë/outreach. Numri i PID që mund të marrin materiale të tilla janë të barabarta me objektivin e mbulimit çdo vit.
- Rishikimi i strategjive dhe aktiviteteve bazuar në përvojën e projektit, rezultatet e mbikëqyrjes së sjelljes dhe çështjeve të ngritura gjatë zbatimit.

3. Sigurimi i shpërndarjes dhe aftësive të përdorimit të kondomit

- Sigurimi që kondomët janë lehtësisht të disponueshëm në zonën e projektit;
- Promovimi i përdorimit të kondomit nëpërmjet shpërndarjes falas të prezervativëve përmes PSHP, edukatorëve bashkëmoshatarëve/punonjësve në terren, shërbimeve lokale të IST.
- Rishikimi i aktiviteteve të edukimit dhe shpërndarjes së kondomit në bazë të përvojës së projektit dhe rezultateve nga mbikëqyrje e sjelljes.

4. Ofrimi i shërbimeve të këshillimit dhe testimit për HIV (TKH)

- Sigurimi i trajnimit për TKH i stafit të projektit për të siguruar shërbime të aksesueshme edhe të pranueshme për PID;
- Ofrimi i këshillimit për HIV dhe testimi i shpejtë në PSHP për PID;
- Ofrimi i testimit në vendet ku PID mblidhen, i cili do të promovohet dhe kryhet përmes njësive mobile;
- Krijimi i shërbimeve TKH në mënyrë që PID të kenë akses në shërbime ose t'i referohen/ t'i shoqërojnë ata në qendrat ekzistuese të TKH;
- Monitorimi i përvojës së PID në shërbimet e TKH dhe ndërmarrja e veprimeve korrigjuese në përmirësimin e aktiviteteve edukative dhe testimit.

4. Promovimi i një mjedisi të përshtatshëm për të adresuar stigmën

- Identifikimi i organizatave/personave ose faktorëve të tjerë që mund të pengojnë progresin e implementimit. Zhvillimi i një plani për të promovuar një mjedis sa më pozitiv për shërbimet e reduktimit të dëmeve për PID.
- Ndërmarrja e aktiviteteve advokuese dhe edukuese për të promovuar dhe siguruar mirëkuptimin e zyrtarëve të qeverisjes vendore, punonjësve të zbatimit të ligjit dhe aktorëve të tjerë lokal për rëndësinë së aktiviteteve gjithëpërfshirëse për parandalimin e HIV.
- Monitorimi i dhunës kundër PID dhe ndërmarrja e veprimeve të duhura.
- Ndermarrja e nje fushate sensibilizuese ne popullsine ne rrezik dhe ate te prekur

6. OST dhe trajtimi tjetër i varësisë nga droga (PID dhe partnerët e tyre)

Shërbimet do të fuqiozohen dhe do të zgjerohen në qendrat ekzistuese të OST-së në Tiranë, Durrës, Shkodër, Vlorë, Korçë dhe Elbasan. Qendra të tjera do të hapen në dy vende të tjera. Aktivitetet do të synojnë rritjen e cilësisë së shërbimeve OST.

3. PROGRAMET E PARANDALIMIT PËR PUNONJËSET E SEKSIT FEMRA (PSF) DHE KLIENTËT E TYRE.

OBJEKTIVAT

Qëllimi i kontratës është të kontrollojë dhe të parandalojë përhapjen e mëtejshme të HIV në popullatën e PSF në rrethet e përzgjedhura të vendit. Kontraktuesi do të ofrojë një paketë shërbimesh të përshkruara më poshtë.

Ndërhyrjet që planifikohen. Fokusi i ndërhyrjes do të jetë Tirana (që pritet të arrijë 70% të objektivit) dhe qytete të tjera.

Fushat e Shërbimeve për PSF. Organizata zbatuese do të ofrojë paketën e mëposhtme të shërbimeve për PSF. Organizata do të përgatisë planin vjetor të punës për zbatimin e këtyre shërbimeve:

- Edukimi për shëndetin seksual dhe riprodhues dhe STI;
- Informacion, edukim dhe komunikimi synuar për PSF;
- Programet e shpërndarjes dhe promovimit të përdorimit të kondomit për PSF-në dhe partnerët e tyre seksualë;
- Ofrimin e shërbimeve të këshillimit dhe testimit për HIV(TKH);
- Promovimi i një mjedisi të përshtatshëm për të mbështetur ndërhyrjet parandaluese të PSF

Më poshtë secilit prej këtyre shërbimeve përshkruhet në detaje.

1. Zbatimi i strategjive të përshtatshme për ndryshimin e sjelljes

- Ngritja e Pikave të Shërbimit të Palëvizshme (PSHP) - si struktura kryesore për ofrimin e shërbimeve gjithëpërfshirëse përPSF. Ngritja e PSHP për PSF do të ofrojë një mjedis të sigurt dhe miqësor për:
 - Diskutime në grupe, këshillime psiko-seksuale, këshilla, informacione dhe mbështetje për ndërtimin e një ndjenje komuniteti midis FSË.
 - Ndërtimi i aftësive për përdorimin e kondomit, aftësitë negociuese, njohuritë për HIV dhe IST, komunikimin ndërpersonal dhe reduktimin e abuzimit me drogën dhe alkoolin;
- Punësimi dhe përgatitja e punonjësve në terren (outreach).
- Trajnimi nëpërmjet edukatorëve bashkëmohatarë në përdorimin e duhur të kondomit, njohuritë për HIV dhe IST.
- Zhvillimi i materialeve të Informim Edukim Komunikimit për PSF, që përfshin: masa parandaluese për të ndërgjegjësuar grupet e targetuara, përgatitjen, fokus grupet për të testuar materialet e reja, shtypjen dhe shpërndarjen. Materialet e IEC do të shpërndahen në terren, në njësitë e lëvizshme, dhe pikat e palëvizshme nga punëtorët socialë/outreach. Numri i PSF të planifikuar për të marrë materiale të tilla do të jetë në përputhje objektivin e mbulimit çdo vit.

2. Sigurimi i shpërndarjes të kondomit

- Sigurimi që kondomët janë lehtësisht të disponueshëm në zonën e projektit;
- Promovimi i përdorimit të kondomit nëpërmjet shpërndarjes falas të prezervativëve përmes PSHP, edukatorëve bashkëmohatarëve/punonjësve në terren, shërbimeve lokale të IST;

- Rishikimi i aktiviteteve të edukimit dhe shpërndarjes së kondomit në bazë të përvojës së projektit dhe rezultateve nga mbikëqyrje e sjelljes.

3. Ofrimin e shërbimeve të këshillimit dhe testimit për HIV (TKH)

- Sigurimi i trajnimit për TKH të stafit të projektit për të siguruar shërbime të aksesueshme dhe pranueshme për PSF;
- Ofrimi i këshillimit për HIV dhe testimi i shpejtë në PSHP për PSF;
- Ofrimi i testimit në vendet ku PSF mblidhen, i cili do të promovohet dhe kryhet përmes njësive mobile;
- Krijimi i shërbimeve TKH në mënyrë që PSF të kenë akses në shërbime ose t'i referohen/ t'i shoqërojnë ata në qendrat ekzistuese të TKH;
- Monitorimi i përvojës së PSF në shërbimet e TKH dhe ndërmarrja e veprimeve korrigjuese në përmirësimin e aktiviteteve edukuese dhe testimit.

4. Promovimi i një mjedisi të përshtatshëm

- Identifikimi i organizatave/personave ose faktorëve të tjerë që mund të pengojnë progresin e implementimit. Zhvillimi i një plani për të promovuar një mjedis sa më pozitiv për shërbimet e parandalimit të HIV te PSF;
- Ndërmarrja e aktiviteteve advokuese dhe edukuese për të promovuar dhe siguruar mirëkuptimin e zyrtarëve të qeverisjes vendore, punonjësve të zbatimit të ligjit dhe aktorëve të tjerë lokal për rëndësinë së aktiviteteve gjithëpërfshirëse për parandalimin e HIV.

4. PROGRAMET PARANDALIMI PËR POPULLATAT E TJERA VULNERABEL (TË BURGOSURIT)

OBJEKTIVAT

Qëllimi i kontratës është të kontrollojë dhe të parandalojë përhapjen e mëtejshme të HIV midis të burgosurve në burgjet e rretheve të përzgjedhura të vendit. Kontraktuesi do të ofrojë një paketë shërbimesh të përshkruara më poshtë.

Ndërhyrjet do të zhvillohen në Tiranë (3 burgje), Durrës, Fier, Berat, Lezhë dhe Peqin.

Fushat e Shërbimeve për të Burgosurit. Organizata zbatuese do të ofrojë paketën e plotë të shërbimeve të mëposhtme për të burgosurit. Organizata do të përgatisë planin vjetor të punës për zbatimin e këtyre shërbimeve:

- Edukimi për parandalimin e HIV, IST, shëndetin seksual;
- Informim, edukim dhe komunikim;

- Programet e shpërndarjes dhe promovimit të kondomit;
- Ofrimin e shërbimeve të këshillimit dhe testimit për HIV(TKH)

Më poshtë secilit prej këtyre shërbimeve përshkruhet në detaje.

1. Zbatimi i strategjive të përshtatshme për ndryshimin e sjelljes

- Trajnimi i edukatorëve bashkëmoshatarë për të ndërtuar aftësitë e të burgosurve në përdorimin dhe hedhjen e prezervativëve, njohuritë e HIV dhe IST;
- Zhvillimi i materialeve IEK për të burgosurit që përfshin: zhvillimin, fokus grupet për të testuar materialet e reja, shtypjen dhe shpërndarjen.

2. Sigurimi i shpërndarjes dhe aftësive të përdorimit të kondomit

- Sigurimi që kondomët të jenë lehtësisht të disponueshëm në burgje;
- Provomimi i përdorimit të kondomit;

3. Ofrimin e shërbimeve të këshillimit dhe testimit për HIV (TKH)

- Këshillimi dhe testimi vullnetar i HIV do të jetë në dispozicion për të gjithë të burgosurit. Shërbimet e VCT do të promovohen përmes stafit mjekësor të trajnuar. Këshillimi do të përfshijë gjithashtu referimin në shërbimet mjekësore dhe sociale sipas nevojës.

5. TRAJTIMI, KUJDESI DHE MBËSHTETJA

OBJEKTIVAT

Qëllimi i kontratës është të sigurojë kujdes të vazhdueshëm dhe mbështetje sociale për personat që jetojnë me HIV (PJH). Kontraktuesi do të ofrojë një paketë shërbimesh të përshkuara më poshtë.

Fushat e Shërbimeve për PJH. Organizata zbatuese do të ofrojë paketën e mëposhtme të plotë të shërbimeve për PJH. Organizata do të përgatisë planin vjetor të punës për zbatimin e këtyre shërbimeve:

1. Këshillimi dhe mbështetja psiko-sociale

- Kryerja e një vlerësimi të shpejtë të kujdesit jo-mjekësor dhe mbështetjes për njerëzit që jetojnë me HIV;
- Zhvillimi i protokollit dhe standarteve; hulumtim operacional, mbështetje për organizatat që ofrojnë kujdes dhe mbështetje për PLHIV;
- Zhvillimi, zbatimi dhe vlerësimi i një programi të plotë informacioni dhe edukimi për PJH, të afërmit e tyre dhe komunitetet ku ata jetojnë;
- Ngritja e kapaciteteve dhe krijimi i grupeve të vetëdhomës;
- Kryerja e një studimi mbi indeksin e stigmës dhe diskriminimit dhe monitorimin e treguesve;

- Forcimi i kapaciteteve të anëtarëve të familjeve të PJH për çështjet që kanë të bëjnë me kujdesin shtëpiak, kujdesin paliativ, të ushqyerit, shëndetin mendor, shërbimet sociale dhe aspektet ligjore;
- Ofrimi i shërbimit psikosocial për fëmijët dhe familjet për forcimin e rrjetit të shërbimeve dhe fuqizimin e sistemit të bashkëpunimit dhe referimit për ato shërbime;
- Vlerësimi dhe matja e cilësisë së shërbimit nga perspektiva e kënaqësisë së klientëve të personave HIV pozitiv

2. Ndërhyrje të tjera për trajtim

- Zhvillimi i protokolleve dhe standarteve të ndryshme që lidhen me trajtimin, monitorimin, infeksionet oportune dhe PITC;
- Protokollet dhe standartet e mëposhtme: 1) Protokollet dhe standartet për monitorimin e ART; 2) Për menaxhimin e HIV/ TB dhe HIV / Hepatitit, 3) Për menaxhimin e infeksioneve bashkë-shoqëruese; 4) Zhvillimi i protokolleve dhe standardeve të mbështetjes psiko-sociale për PJH; 5) Zhvillimi i standardeve të cilësisë për VCT; 6) Zhvillimi i protokolleve dhe standardeve për Këshillimin dhe Testimin e Inciuar nga ofruesit e Shërbimeve;
- Trainimi i personelit mjekësor .

6. FUQIZIMI I KOMUNITETIT TE ORGANIZATAVE JO FITIMPRURESE

OBJEKTIVAT

Qëllimi i kontratës është të forcojë kapacitetet institucionale, planifikimin dhe zhvillimin e lidërshiptit të komunitetit OJF. Kontraktuesi do të dorëzojë një paketë shërbimesh të përshkruara më poshtë.

Fushat e Shërbimeve. Organizata zbatuese do të ofrojë shërbimet e mëposhtme. Organizata do të përgatisë planin vjetor të punës për zbatimin e këtyre shërbimeve:

1. Ngritja e kapaciteteve institucionale, planifikimit dhe zhvillimit të lidërshiptit

- Zhvillimi i një plani forcimi institucional, i cili do të identifikojë prioritetet e përgjithshme midis OJF; ky plan i përgjithshëm do të plotësohet me plane më specifike, të cilat i përgjigjen nevojave specifike të organizatave individuale.
- Ngritja e ekipeve të edukimit shëndetësor në nivel komunitar (për personelin shëndetësor dhe një anëtar të komunitetit ose aktivist i shoqërisë civile) (nga organizatat e shoqërisë civile që punojnë në zonat më të prekura me TB)
- Trajnimi i ekipeve për informacion shëndetësor dhe edukim. Organizimi i seancave të edukimit në komunitet. Sesioni i edukimit shëndetësor në nivel komuniteti do të organizohet në tema të

diskriminimit të stigmës dhe do të përmirësojë njohuritë e anëtarëve të komunitetit për shenjat e hershme të tuberkulozit, masat parandaluese dhe mirëmbajtjen e trajtimit.

- Hartimi strategjisë së komunikimit për parandalimin e HIV dhe TB në komunitetin Rom.
- Trajnimi i personelit mjekësor dhe komunitetit rom në lidhje me parandalimin e HIV dhe TB
- Ofrimi i testimit për HIV dhe depistimi për TB në komunitetin Rom

2. Mobilizimi social, ndërtimi i lidhjeve të komunitetit, bashkëpunimi dhe koordinimi

- Fushata e komunikimit që do të organizohet në disa rrethe si një aktivitet plotësues për të mbështetur punën e komunitetit. Fushata do të angazhojë OJF-të lokale dhe mediat. Aktivitetet në kuadër të fushatës do të përfshijnë trajnimin e gazetarëve, shfaqjen e bisedave televizive, artikujt në mediat e shtypura, zhvillimin dhe shpërndarjen e materialeve të IEC;
- Krijimi i një rrjeti komuniteti të OJF (që janë të rinjtë, gratë, studentët ose grupet e tjera të organizatave të komunitetit) që synojnë identifikimin e hershëm (dhe referimin) e personave në rrezik në komunitet (PSF, MSM, PID);
- Trajnimi i stafit kyç të OJF në zbulimin e hershëm të popullatave kyc në komunitetin e tyre dhe raportimin mbi to;
- Zhvillimin e mekanizmit të mbledhjes së të dhënave të bazuara në komunitet.